



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**OBJEKTIVAT FORMUES DHE KARAKTERISTIKAT E PROGRAMIT
MASTER PROFESIONAL NË INFERMIERI PATOLOGJIKE**

Profili kulturor dhe profesional i studimit në përfundim të programit mësimor

Programi i studimit: MP në Infermieri Patologjike synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermierisë patologjike. Ai ka për objektiv të përgatisë infermierë patologë me formim të avancuar për të ofruar kujdes shëndetësor të kualifikuar për gjithë njerëzit që vuajnë nga patologji jokirurgjike në moshën e adultit (nga adoleshenca e deri në fund të moshës së tretë).

Ky kualifikim ofron njohuri disiplinare të thelluara në infermieri patologjike të avancuar. Nëpërmjet këtij masteri profesional, studentët aftësohen të demonstrojnë mjeshtëritë në integrimin e koncepteve infermierore në disiplina të ndryshme si dhe aftësinë të zbatojnë njohuritë teknike për të zgjidhur një problem shëndetësor.

Gjithashtu i përgatit studentët të realizojnë ndërhyrje bazë te pacientët si dhe ndihmon në përmbushjen e detyrave bazë të kërkuara prej një infermieri profesionist.

Studentët do të aftësohen gjithashtu për të komunikuar në mënyrë profesionale edhe me publikun për teknikat infermierore që aplikohen në patologji, duke fituar mjeshtëri dhe përvojë në komunikimin formal dhe informal me studentë, infermierë, mjekë dhe specialistë të kujdesit shëndetësor.

Ky program synon:

- Të lehtësojë zhvillimin e njohurive, aftësive për aplikim në mjediset e infermierisë patologjike.
- Të zgjerojë njohuritë e studentëve për kërkim shkencor në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të praktikës.

Në përfundim të programit të studimeve studentët do të marrin diplomën: **Master profesional në Infermieri Patologjike.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor.

Në përfundim të programit mësimor studentët do të jenë të aftë:

- Të analizojnë në mënyrë kritike konceptet dhe teorinë rreth njohjes, përgjigjes dhe menaxhimit të gjëndjes shëndetësore tek pacienti adult dhe geriartrik në qendrat shëndetësore.
- Të identifikojnë konceptet kyçe që lidhen me punën me adultët dhe familjarët e tyre, si ruajtjen e sigurisë, kujdesi dhe trajtimi, teorinë e lidhjes dhe angazhimit me pacientin dhe familjen.
- Të vlerësojnë faktorët socio – ekonomik, fiziologjik dhe psikologjik që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqënien e adultëve, të moshuarve dhe familjeve të tyre.
- Të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në shërbimin shëndetësor ku ata do të / jenë punësuar.

Mundësitë për punësim

Në përfundim të këtij programi të ciklit të dytë të studimeve studentët do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për të ofruar një kujdes infermieror me cilësi të lartë, bashkëkohor, të bazuar mbi gjykimin kritik të fakteve tek një spektër i gjerë pacientësh në çdo hallkë të shërbimit patologjik:

- Reparti i Patologjisë - Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Reparti i Semundjeve infektive – Terapi Intesive / Spital Rajonal, rrethi apo Spitalet Universitare
- Shërbimi i patologjisë / Shërbimi shëndetësor dytësor
- Spitali Psikiatrik i Vlorës
- Kompanitë e kujdesit shëndetësor, spitale, qendra shëndetësore, shtetërore dhe private, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.